



PROCESVERBAL

Mbledhja e rregullt e Komitetit për Politikë dhe Financa (KPF), e mbajtur më 16.03.2023, me fillim në ora 10:00. Mbledhjen e kryesoi Kryesuesi i Kuvendit, zt. Defrim Kafexhiu.

Kryesuesi – Fillimisht më lejoni t'ju përshtendes të gjithëve, Nënkyetarin Fatmir Iska, drejtoret e drejtoreve. Të nderuar anëtarë të Komitetit për Politikë dhe Financa, drejtore të drejtoreve, zyrtarë komunalë, të gjithë ju të pranishëm. Faleminderit shumë për pjesëmarrjen. E hapim mbledhjen e 3-të të Komitetit për Politikë dhe Financa për vitin 2023.

Në konsultim me kryetarin e komunës kemi përgatitur këtë;

REND DITE

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Shqyrtimi i propozimvendimit për faljen e borxheve të papaguara për taksat në aktivitete (afariste), nga data 1.1.2000– 31.1.2017;
3. Shqyrtimi i propozimvendimit për shfuqizimin e vendimit 01 Nr.149/2006, i datës 14.7.2006;
4. Shqyrtimi i propozimvendimit për shpalljen me interes të përgjithshëm publik P-71510057-05539-0 zona kadastrale Rahovec;
5. Shqyrtimi i propozimvendimit për dhënien e pëlqimit për këmbimin e pronës publike me Institucionin Qëndror – zona kadastrale Rahovec;
6. Shqyrtimi i propozimvendimit për riparcelizim të parcelave në zonën kadastrale Rahovec;
7. Shqyrtimi i Draft Rregullores për Menaxhimin e Mbeturinave në territorin e Komunës së Rahovecit;
8. Informatë mbi listën e pronave komunale dhe menaxhimi i tyre;
9. Informatë për mirëmbajtjen e rrugëve gjatë sezonës dimërore;
10. Të ndryshme.

Kryesuesi – A ka dikush prej anëtarëve të KPF-së ndonjë propozim apo koment rrëth pikave të rendit të ditës?... Nëse jo, atëherë ekzekutivi, saktësisht nënkyetari, e ka një propozim shtesë për rend dite.

Nënkyetari – Faleminderit kryesues, të nderuar anëtarë të KPF-së, të gjithë të pranishëm. Kërkojmë një pikë shtesë në rend dite, vendim mbi themelimin e Ansamblit të Këngëve dhe Valleve në Rahovec.

Kryesuesi – Atëherë, nëse jeni të pajtimit po e e vendosim në votim që të shtohet në rend dite kjo pikë. Kush është “për”?... Me shumicë unanime, shtohet edhe një pikë në rend dite. Rendi i ditës tanë i ka 11 pika, si të tillë po e vendosim në votim, kush është “për”?... Me shumicë votash miratohet rendi i ditës për sot.

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;

Kryesuesi – A ka dikush prej anëtarëve të KPF-së ndonjë koment apo vërejtje rrëth procesverbalit?... Nëse jo, po e vendosim në votim, kush është për?... Me shumicë votash miratohet procesverbali i mbledhjes së kaluar.

2. Shqyrtimi i propozimvendimit për faljen e borxheve të papaguara për taksat në aktivitete (afariste), nga data 1.1.2000– 31.1.2017;

Erhan Morina – Faleminderit kryesues. I nderuar nënkyetar, drejtorë të drejtorive, anëtarë të KPF-së. Para jush keni propozim vendimin për faljen e borxheve të papaguara për të gjitha bizneset pasive nga viti 2000 deri më 31 dhjetor 2017. Në metrialin që iu kemi dërguar është bërë një lëshim teknik, tani qe ju dhash materialin është final. Bëhet fjalë për një listë të bizneseve dhe borgjeve të akumuluara nga 2000-2017. Ky borxh juridikish konsiderohet si borxh i keq, poashtu juridikisht nuk kemi mekanizma për inkasimin e tyre. Vlera e borxhin që propozohet të falet është 346.213 euro dhe përfitojnë 755 biznese.

Burim Krasniqi – Faleminderit kryesues. Përvendetje nënkyetar, drejtor, kolegë. Mirë është që falen borxhet, të painkasueshmet mund të realizohen me përmbarim, ekziston mekanizmi i realizimit. E kam një propozim: Te propozim vendimi, meqenëse shumica e bizneseve janë pasive (nuk janë të shuara), ta vendosim në një prej neneve një pasues sipas mundësive që nëse këto biznese aktivizohen, ta kthejnë borxhin.

Erhan Morina – Faleminderit Burim. Realisht kjo është lista e biznese që në sistem të ARBK-së janë pasive, por nëse ju propozoni që nëse bizneset aktivizohen, mund t'i ngarkojmë me borxhin që e kanë.

Kryesuesi – Atëherë, këtë propozim të Burim Krasniqit e vendosim së bashku me vendimin për në seancën e rregullt, këtu vendimin po e vendosim në votim ashtu siç ka qenë.

Afram Limani – Propozimi i Burimit është me vend, mirëpo duhet ta kemi parasysh edhe situatën kshtu: Nëse eventualisht një biznes aktivizohet me numër të njejtë fiskal, atëherë po, por nëse i njëjti biznes regjistrohet me nr. fiskal tjetër, konsideroj që nuk mund ta vendosim në këtë pasues.

Erhan Morina – Propozimi është i mirë, por ndoshta është më mirë të bëhet për bizneset që aktivizohen në 2023 dhe jo për ata 2024-2025 e tutje sepse krijohet “hallakamë”.

Kryesuesi – Atëherë, për shkak të korrektësisë propozimin e Burimit po e vendosim në votim edhe këtu, për diskutim në kuvend. Kush është “për”?... Me 3 vota “për” dhe 2 abstenime ky propozim i bashkëngjitet vendimin aktual. Kush është “për” për pikën e dytë?... Me shumicë votash aprovohet edhe pika e dytë.

3. Shqyrtimi i propozimvendimit për shfuqizimin e vendimit 01 Nr.149/2006, i datës 14.7.2006;

Erhan Morina – Faleminderit kryesues. Para jush keni propozimvendimin për shfuqizimin e vendimit 01 Nr.149/2006, i datës 14.7.2006. Fjala është për parcelën 002666-0 në zonën kadastrale Hoçë e Madhe. Aktualisht afati ligjor i këtij vendimi ka mbaruar dhe qëllimi i shfuqizimit të këtij vendimi është që pas aprovimit nga kuvendi, ne mundemi ta pastrojmë certifikatën e pronës të shfrytëzuesit të deritanishëm. Në seancën e radhës ta japim në procedurë të rregullt në shfrytëzim përmes ankandit publik.

Kryesuesi – Faleminderit drejtor. A ka dikush prej anëtarëve të kuvendit ndonjë gjë rreth kësaj pike të rendit të ditës?... Nëse jo, atëherë po e vendosim në votim, kush është “për”?... Me 4 vota “për” dhe 1 kundër, aprovohet edhe pika e tretë.

4. Shqyrtimi i propozimvendimit për shpalljen me interes të përgjithshëm publik P-71510057-05539-0 zona kadastrale Rahovec;

Afram Oruqi – Faleminderit kryesues! I nderuar nënkyetar, kolegë drejtorë, anëtarë të KPF-së. Në bazë të ligjeve në fuqi, kryetari i komunës ju propozon shpalljen me interes të përgjithshëm publik të parcelës 05539-0 zona kadastrale Rahovec 100m katror (Te pompa e benzinës “Shell”, ana e majtë – rruga për Brestoc). Në procedurat e ardhshme kur dokumentet të marrim ligjshmëri, qëllimi është të marrim pëlqim për këmbim të parcelës në fjalë.

Burim Krasniqi – Drejtor, a është biseduar me familjen?... A është e koordinuar si punë, që komuna mos të ketë konteste tjera.

Afram Oruqi – Po, ka kërkesë me shkrim prej pronarit dhe pajtueshmëri të plotë.

Kryesuesi – Faleminderit drejtor. A ka dikush prej anëtarëve të kuvendit ndonjë gjë tjetër?... Nëse jo, po e vendosim në votim, kush është “për”?... Me shumicë votash aprovohet edhe pika e katërt e rendit të ditës.

5. Shqyrtimi i propozimvendimit për dhënien e pëlqimit për këmbimin e pronës publike me Institucionin Qëndror – zona kadastrale Rahovec;

Afrim Oruqi – Faleminderit kryesues, sipas ligjeve në fuqi kryetari i komunës i propozon KPF-së dhënien e pëlqimit për këmbimin e pronës publike me Institucionin Qëndror – zona kadastrale Rahovec. Bëhet fjalë për dy parcela, një është në mbi shkollën filllore “Bekim Sylka” (22 ari e 61m katror), kjo parcelë të këmbehet (do t'i jepet komunës) me një parcelë të komunës e cila gjendet në zonën kadastrale në Rahovec (Rahovec – Drenoc, në sipërfaqe prej 1ha 9 ari e 77m katror e cila jepet në posedim Agjencisonit Pyjor të Kosovës.

Kryesuesi – Faleminderit drejtor. A ka dikush prej anëtarëve të kuvendit ndonjë gjë rrëth kësaj pike?... Nëse jo, po e vendosim në votim, kush është “për”?... Me shumicë votash aprovohet edhe pika e pestë.

6. Shqyrtimi i propozimvendimit për riparcelizim të parcelave në zonën kadastrale Rahovec;

Afrim Oruqi – Sipas legjislacionit në fuqi, kryetari i komunës i propozon KPF-së miratimin e vendimit për riparcelizimin e parcelave kadastrale, bëhet fjalë për parcelën priavate e cila gjendet në pjesën që fatmirësish ka filluar të ndërtohet sheshi qendror i qytetit. Parculla është në pronësi të pronarëve privat: Hajrullah Bahjtar Dula, Tasim Bahjtar Dula dhe Hysnije Sefer Dula, me sipërfaqe prej 8 ari e 28m katror. Ky riparcelizim nënkupton drejtimin e parcelës në atë kahje që nuk do të ishte pengesë për projektin e sheshit.

Kryesuesi – Faleminderit drejtor. A bëhet riparcelizimin në koordinim me pronarët?...

Burim Krasniqi – Faleminderit kryesues! Jo fatmirësish, por është fatkeqësisht që niset sheshi pa i dhënë zgjidhje çështjeve të caktuara. Në momentin kur është ndërtuar tregu e kemi ditur që parcelat janë në mes hapësirave publike që i posedon Komuna e Rahovecit. Po e shoh joserioz këtë veprim, kur sheshi ka filluar të ekzekutohet. Si e shihni epilogun e kësaj çështje, a do të përfundojë lehtë, apo do të ketë një lloj pazari prej palëve që mund të ketë mospajtme me formën e ndryshimit dhe nëse lënda shkon në gjykatë, si e shihni epilogun e ekzekutimit të sheshit në këtë pjesë të parcelave private?...

Afrim Oruqi – Më vie keq që teknikisht projektori nuk është funksional për prezantimin e ortofotos. Fillimisht po i përgjigjtem pyetjes së kryesuesit; Ne i kemi zhvilluar bashkë me pronarët e parcelës tri takime duke i dikutuar procedurat dhe ndryshimet që parashihen me ligj dhe pajtueshmëri të plotë.

Në pyetjen e Kuvendarit Burim Krasniqi; Ky proces ka filluar në 2003-2004, ka pasur kërkesa prej palëve që ta përfundojmë këtë punë, sepse parcela në atë kohë nuk ka pasur çasje në rrugë. Në atë kohë ka qenë kryeshefi, i nderuari Ibrahim Kryeziu kur këta kanë provuar ta kryejnë këtë punë. Kjo parcelë edhe kështu si është nuk prishë punë asgjë, vetëm që dëshirojmë ta rregullojmë më mirë dhe parcelën ta kthejmë në drejtim të stadiumit.

Burim Krasniqi – Me gjithë respektin, këto “salltet” politike nuk më pëlqejnë; “na ka mbetur në dorë kur ka qenë LDK”, këto janë “sallta” që dikujt i shkojnë për fytyre e dikujt hiç. E dyta, nuk mund të thuash që nuk ka problem edhe nëse e lëmë ashtu parcelën, kur ekziston projekt total. Me profesion jam inxhinier dhe projekt i është projekt, kur lidhet kontrata për zbatimin e gjithë projektit. A është gabim që nuk është bërë para se të lidhet kontrata për sheshin? Po, është gabim sepse sheshi nuk ka ardhur befasisht.

Kryesusi – Faleminderit Burim. Dikush tjetër?... Nëse jo, atëherë po e vendosim në votim, kush është “për”?... Me 3 vota “për” dhe 1 abstenim aprovohet edhe pika e gjashtë e rendit të ditës.

7. Shqyrtimi i Draft Rregullores për Menaxhimin e Mbeturinave në territorin e Komunës së Rahovecit;

Përparim Krasniqi – Faleminderit kryesues, përshëndetje për të gjithë anëtarët e KPF-së. Për herë të parë po bëhet një rregullore e re në nivel komunal, kjo për menaxhim të mbeturinave. Do ta kemi ndryshimin e taksës për mbeturina që do të ketë një ngritje prej 1.5 prej gjendjes aktuale që e kemi. Një vendim tjetër nga qeveria e

Kosovës bën që të ndryshohet çmimi në deponinë e mbeturinave në Prizren (deponia regionale), ngritja është 2 euro.

Kryesuesi – Faleminderit drejtor! A ka dikush prej anëtarëve të KPF-së ndonjë pyetje?... Atëherë, unë e kam një! Te kërkesa për rritjen e çmimit për familje, a duhet patjetër që komuna ta aprovojë kërkesën e Ekoregjonit, apo komuna ka kompetencë sesi ta shih të arsyeshme në interes të banorëve, pavarësisht që deponitë e kanë rritur çmimin për ton të mbeturinave.

Përparim Krasniqi – Faleminderit kryesues, të gjitha komunat kanë filluar ta ngrisin taksën sepse është shumë e ulët, po e ngirisim 1.5 euro bashkë me TVSH. Nuk është propozim nga Ekoregioni, për nga niveli qëndro për shkak të inflacionit.

Burim Krasniqi – Faktikisht komunat e marrin vendimin për rritjen e tarifës, te rritja e tarifës, a parashihet vetëm rritja e kostos së shpenzimeve për ta rritur tarifen, apo parashihet edhe ngritja e pagave të punëtorëve të mirëmbajtjes?... Sepse pagat aktuale janë të dhimbshme.

Përparim Krasniqi – Propozimi prej 6 euro, ka qenë në diskutim publik dhe kanë qenë kontribues bizneset, kryetarët e fshatrave, lagjeve urbane etj... Ferizaji e ka 7 euro, Rahoveci, një ndër komunat që e ka më pak.

Kryesuesi – Faleminderit drejtor! A ka dikush prej anëtarëve të KPF-së ndonjë gjë tjeter?... Atëherë po e vendosim në votim, kush është "për"?... Me shumicë votash aprovohet pika e shtatë. Sa i përket pikes 8-të dhe 9-të, kërkoj mirëkuptimin e anëtarëve të komitetit që t'i kalojmë për në kuvend meqenëse janë vetëm informata.

8. Informatë mbi listën e pronave komunale dhe menaxhimi i tyre;

9. Informatë për mirëmbajtjen e rrugëve gjatë sezonës dimërore;

Kryesuesi – Atëherë, po i vendosim në votim, kush është "për"?... Me shumicë votash aprovohen për diskutim në kuvend. Vazhdojmë me propozimin e drejtorit Afrim Dina.

10. Shqyrtimi i propozimvendimit për themelimin e Ansamblit Komunal të Këngëve dhe Valleve në Rahovec;

Afrim Dina – Faleminderit kryesues! I nderuar nënkyetar, kolegë, anëtarë të KPF-së. Para vetes keni propozimin e kryetarit të komunës për themelimin e Ansamblit Komunal të Komunës së Rahovecit, në mbështjetje të ligjit 03/L-040 për Vetqeverisje Lokale, si dhe nenit 5 paragrafi 2 të ligjit 04 L/164 për Ansamblit Kombëtar të Valleve "Shota" dhe Ansamble tjera. Kërkoj nga ju që ta kalojmë këtë pikë për kuvend dhe më pas të merret aprovin i kuvendit për fillimin e procedurave tutje (konsultimi publik dhe statuti i ansamblit).

Kryesuesi – Faleminderit drejtor! A ka dikush prej anëtarëve të KPF-së ndonjë gjë rreth këtij propozimi?... Nëse jo, atëherë po e vendosim në votim, kush është "për"?... Me shumicë votash aprovohet edhe pika shtesë.

11. Të ndryshme;

Kryesuesi – Atëherë, me pikën e fundit po e përmbyllim mbledhjen e tretë të KPF-së, shihemi në seancën e rregullt të kuvenit.

Mbledhja përfundoi në ora 10:40

Procesmbajtësi;

Albin Krasniqi



KRYESUESI

Dëfrim Kafexhiu